



TË DREJTAT E AVIOUDHËTARIT



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Infrastrukturës
 Ministarstvo za Infrastrukturu
 Ministry of Infrastructure

Ju duhen më shumë informata?

Thirrni në këtë numër telefoni gjatë ditëve të punës prej orës 08:00-16:00
(0)38 200 28 105



MOHIM I HYRJES NË AEROPLAN? ANULIM? VONESË E GJATË?

Kompanitë ajrore kanë obligim ligjor t'ju informojnë mbi

TË DREJTAT E JUAJA DHE KU TË ANKOHENI

➤ Mohimi i hyrjes në aeroport

Juve mund t'ju takojë kompensimi midis €125 dhe €600 varësisht nga distanca e fluturimit si dhe vonesa që është shkaktuar për shkak të ndërrimit të itinerarit.

➤ Vonesat e gjata

Nëse vonesa është më e gjatë se 5 orë dhe ju vendosni të mos fluturoni, ju mund të kërkonti që t'iu kthehen paratë e biletës.

➤ Anulimi

Ju takon kompensim financiar përpos nëse ju jeni informuar 14 ditë para fluturimit mbi anulimin ose ju është ndërruar itinerari i cili është i përafërt me kohët origjinale të fluturimit ose nëse kompania ajrore mund të dëshmojë se anulimi është shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme.

➤ Asistenca nga kompanitë ajrore

Varësisht nga rrethanat, nëse juve iu është mohuar hyrja në aeroport ose nëse fluturimi juaj është anuluar ose vonuar kompania ajrore mund t'ju ofrojë asistencë (ushqim, qasje në komunikim si dhe akomodim në hotel nëse është e nevojshme). Në rastet e mohimit të hyrjes në aeroport ose anulimit, juve mund t'ju ofrohet që ta vazhdoni fluturimin ose t'ju kthehen paratë e biletës së suaj.

Në Republikën e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës është autoriteti përgjegjës për sigurimin e këtyre të drejtave. Për më shumë informata vizitoni: <http://www.mi-ks.net>

Lista e autoriteteve kombëtare përgjegjëse për sigurimin e këtyre të drejtave në Shtetet e Bashkuara Evropiane mund të gjendet në faqen e internetit: <http://apr.europa.eu>

Identiteti i kompanisë ajrore

Ju duhet të jeni të informuar paraprakisht se me cilën kompani ajrore do të fluturoni. Kompanitë ajrore të cilat konsiderohen si të pasigurta nuk lejohen të fluturojnë në Bashkësinë Evropiane. Lista e tyre mund të gjendet në faqen e internetit: <http://www.mi-ks.net>

Përgjegjësia

Kompanitë ajrore mund të konsiderohen përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga vonesat (deri në ± € 4 800), për dëmtimin ose humbjen e valixhes (deri në ± € 1 200) si dhe për lëndim ose vdekje në aksident. Sidoqoftë, kompanitë ajrore nuk janë përgjegjëse nëse kanë marrë të gjitha masat e arsyeshme për t'iu shmangur dëmtimeve ose poqese ka qenë e pamundur për t'i marrë këto masa.